



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 09.09.2015

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “RESTAURIMIN E ZYRËS SË PRITJES
DHE NDRIÇIMIN E FASADËS SË GODINËS SË MINISTRISË SË MIRËQËNIES
SOCIALE DHE RINISË”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 19 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Restaurimin e zyrës së pritjes dhe ndriçimin e fasadës së godinës së Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë”, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Tiranë, me subjekt kërkuës Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Ngarkohet Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

BLENDI KLOSI

MINISTËR I MIRËQENIËS SOCIALE DHE RINISË

SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT